



Legal Alert Albania

December 2024 - January 2025





**Instruction No. 1020, Dated November 25, 2024:
Amendment to Instruction No. 757, Dated
September 30, 2024, "On the Procedures for
Reviewing, Evaluating, and Approving Licensing
Requests for Entities Engaged in Employment
Mediation Activities and Their Monitoring"**

A crucial amendment, enacted through Instruction No. 1020, modifies Instruction No. 757 pertaining to the licensing process for entities in employment mediation.

Capital Reserve Requirement: Entities must now establish and certify a capital reserve for third-party security amounting to no less than 1,000,000 (one million) ALL, replacing the previous requirement of five minimum wages.

All entities in this sector must adjust to these new requirements to maintain their licensing status under the updated regulatory framework.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([link](#))


**Udhëzim Nr. 1020, datë 25.09.2024: Për një
ndryshim në udhëzimin nr. 757, datë 30.9.2024,
"Për procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe
miratimit të kërkesave për licencim, të subjekteve
që kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në tregun
e punës dhe monitorimin e tyre"**

Një amendament i rëndësishëm është implementuar me anë të Udhëzimit Nr. 1020, i cili amendon Udhëzimin Nr. 757 në lidhje me procedurat e licencimit për entitetet që operojnë në ndërmjetësimin e punësimit.

Detyrimi për Kapitalin si Rezervë Sigurie: Sipas dispozitave të reja, entitetet janë të detyruara të krijojnë dhe të ngurtësojnë një kapital si rezervë sigurie për të tretët, me një minimum prej 1,000,000 (një milion) lekë, duke zëvendësuar kërkesën e mëparshme prej pesë pagash minimale.

Të gjitha entitetet në këtë sektor duhet të përshtaten me këtë kërkesë të re, për të ruajtur statusin e tyre të licencimit sipas kuadrit të përditësuar rregullator.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë ([link](#))





Decision of the Council of Ministers No. 703, dated 13.11.2024 "On some additions and amendments to Decision No. 101, dated 23.2.2018, of the Council of Ministers, "On the organization and functioning of private employment agencies.

The Council of Ministers of Albania has introduced amendments to Decision No. 101, dated February 23, 2018, regarding the operation and organizational regulations for private employment agencies. The changes were enacted under Decision No. 703 on November 13, 2024, aiming to enhance transparency, accountability, and regulatory compliance.

Key Amendments:

Regulatory Transparency: The responsible ministry will now publish approval, rejection, and revocation of licenses in the National Register of Licenses and Permits.

Administrative Documentation: Employment agencies are required to include identification documents of job seekers and potential employers as part of their administrative files.

Agency Records and Financial Security:

- Agencies must maintain detailed records of mediations, including registries of both mediated individuals and employers.
- The agency, throughout its activity, must maintain a minimum security reserve of no less than 1,000,000 (one million) lek, verifiable through a document issued by a bank or an insurance company, licensed by the state to conduct this activity, which can be used for compensations to third parties.

Equality and Ethical Standards: Agencies are mandated to provide equal treatment to all job seekers and adhere to principles respecting human rights, non-discrimination, professionalism, and data protection and confidentiality.

Periodic Reporting: Every six months, agencies must report to the relevant employment ministry detailing their structure, activities, and compliance with licensing criteria.

License Revocation Authority: The authority to revoke a license now rests directly with the employment ministry, rather than merely notifying the National Business Center.

Public Accessibility of Information: The Ministry of Employment, State Labor Inspectorate, and National Employment and Skills Agency will publish data on licensed private employment agencies on their official websites.

Transitional Provisions: Active license holders in subcategory X.2.A are obliged to comply with the new criteria within 120 calendar days to maintain their licenses. Failure to adhere to these changes will result in license revocation.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([Link](#))

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 703, datë 13.11.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 101, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencive private të punësimit"

Këshilli i Ministrave ka prezantuar ndryshime në Vendimin Nr. 101, datë 23 shkurt 2018, lidhur me rregulloret e funksionimit dhe organizimit për agjencitë private të punësimit. Ndryshimet u miratuan me Vendimin Nr. 703, më 13 nëntor 2024, me qëllim për të rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe përputhshmërinë rregulatore.

Ndryshimet Kryesore:

Transparenca Rregulatore: Ministria përgjegjëse do të publikojë miratimin, refuzimin dhe revokimin e licencave në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.

Dokumentacioni Administrativ: Agjencitë e punësimit janë të detyruara të përfshijnë dokumentet e identifikimit të kërkuessve të punës dhe punëdhënësve potencialë si pjesë e dosjeve të tyre administrative.

Regjistrat e Agjencisë dhe Siguria Financiare:

- Agjencitë duhet të mbajnë regjistra të hollësishtëm të ndërmjetësimeve, duke përfshirë regjistrat e individëve të ndërmjetësuar dhe punëdhënësve.
- Agjencia, gjatë gjithë aktivitetit të saj, duhet të mbajë një rezervë sigurie minimale jo më pak se 1,000,000 (një milion) lekë, të verifikueshme përmes një dokumenti të lëshuar nga një bankë ose shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të kryer këtë aktivitet, e cila mund të përdoret për kompensime ndaj palëve të treta.

Barazia dhe Standardet Etike: Agjencitë janë të obliguara të ofrojnë trajtim të barabartë për të gjithë kërkuessit e punës dhe të respektojnë parimet që respektojnë të drejtat e njeriut, mosdiskriminimin, profesionalizmin, dhe mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave.

Raportimi Periodik: Çdo gjashtë muaj, agjencitë duhet të raportojnë te ministria përkatëse e punësimit duke detajuar strukturën, aktivitetet dhe përputhshmërinë e tyre me kriteret e licencimit.

Autoriteti i Revokimit të Licencës: Autoritetin për të revokuar një licencë tani e ka direkt Ministria përgjegjëse për çështjet e Punësimit, dhe nuk ka më si rol vetëm njoftimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Disponueshmëria Publike e Informacionit: Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive do të publikojnë të dhëna mbi agjencitë private të punësimit të licencuara në faqet e tyre zyrtare të internetit.

Dispozita Kalimtare: Mbajtësit aktivë të licencave në nënkategorinë X.2.A janë të detyruar të përmbushin kriteret e reja brenda 120 ditëve kalendarike për të ruajtur licencat e tyre. Mosrespektimi i këtyre ndryshimeve do të rezultojë në revokimin e licencës.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë ([Link](#))



Decision of the Council of Ministers No. 695, dated 13.11.2024 "On the approval of support measures, rules, and procedures for benefiting from support measures for the production of electricity from renewable sources."

The Albanian Council of Ministers has adopted Decision No. 695, dated November 13, 2024, a comprehensive legal framework designed to promote electricity production from solar and wind renewable energy sources. This decision sets out specific measures, regulations, and procedures for allocating support, marking a significant step towards achieving Albania's renewable energy goals.

The decision outlines two distinct competitive processes for awarding support:

Procedure with defined location: The government will pre-select the location and installed capacity for solar and/or wind power plants.

Procedure with undefined location: Applicants propose project sites and capacities, aligning with government-defined criteria.

Both processes emphasize a competitive, transparent, and non-discriminatory approach, prioritizing projects that offer the best conditions in terms of energy price, technology, and construction methods.

Key features of the support measures include:

- Support agreements: In the form of Power Purchase Agreements (PPAs) or Contracts for Difference (CfDs), with durations up to 15 years, as per Law No. 24/2023 on promoting renewable energy use.
- Land provision: For procedures with defined location, the government will provide land for the project without charge.
- Grid access: Guaranteed connection and access to the transmission/distribution network.
- Permitting support: The government will facilitate the obtaining of necessary permits and authorizations.

The decision also establishes a dedicated fund to cover support scheme costs, managed by the Renewable Energy Operator. A specialized commission will be responsible for drafting tender documents, evaluating bids, and negotiating final agreements.

Decision No. 695 replaces the previous decision on support measures for renewable energy (Decision No. 349, dated June 12, 2018), streamlining and clarifying the framework for renewable energy development in Albania.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([Link](#))

Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 13.11.2024 "Për miratimin e masave mbështetëse, rregullave dhe procedurave për përfitimin e masave mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme"

Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr. 695, datë 13 nëntor 2024, një kuadër ligjor gjithëpërfshirës të dizajnuar për të nxitur prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë diellore dhe erës. Ky vendim përcakton masa specifike, rregullore, dhe procedura për dhënien e mbështetjes, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt arritjes së objektivave të energjisë së rinovueshme të Shqipërisë.

Vendimi përshkruan dy procese të veçanta konkurruese për dhënien e mbështetjes:

Procedura me vendndodhje të përcaktuar: Qeveria do të përzgjerorë paraprakisht vendndodhjen dhe kapacitetin e instaluar për impiantet e energjisë diellore dhe/ose erës.

Procedura me vendndodhje të papërcaktuar: Aplikantët propozojnë vendet e projekteve dhe kapacitetet, duke u përputhur me kriteret e përcaktuara nga qeveria.

Të dy proceset theksojnë një qasje konkurruese, transparente dhe jo-diskriminuese, duke i dhënë prioritet projekteve që ofrojnë kushte më të mira sa i përket çmimit të energjisë, teknologjisë dhe metodave të ndërtimit.

Karakteristikat kryesore të masave mbështetëse përfshijnë:

- Marrëveshjet e mbështetjes: Në formën e Marrëveshjeve për Blerjen e Energjisë (MBE) ose Kontrata për Diferencën (CfDs), me kohëzgjatje deri në 15 vjet, sipas Ligjit Nr. 24/2023 për promovimin e përdorimit të energjisë së rinovueshme.
- Sigurimi i tokës: Për procedurat me vendndodhje të përcaktuar, qeveria do të sigurojë tokën për projektin pa pagesë.
- Hyrja në rrjet: Lidhja dhe hyrja e garantuar në rrjetin e transmetimit/shpërndarjes.
- Mbështetje në marrjen e lejeve: Qeveria do të lehtësojë marrjen e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme.

Vendimi gjithashtu vendos një fond të dedikuar për të mbuluar kostot e skemës së mbështetjes, i menaxhuar nga Operatorët e Energjisë së Rinovueshme. Një komision i specializuar do të jetë përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit, vlerësimin e ofertave dhe negociatat për marrëveshjet përfundimtare.

Vendimi Nr. 695 zëvendëson vendimin e mëparshëm mbi masat mbështetëse për energjinë e rinovueshme (Vendimi Nr. 349, datë 12 qershor 2018), duke e thjeshtuar dhe sqaruar kuadrin për zhvillimin e energjisë së rinovueshme në Shqipëri.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë ([Link](#))



Minister's Instruction of the Minister of Economy, Culture and Innovation No. 980, dated 15.11.2024 "On determining the form and method of submitting requests for approval as a user to conduct activities within technological and scientific parks."

The Albanian Ministry of Economy, Culture, and Innovation has published Instruction No. 980/2024, a comprehensive directive designed to simplify the process for individuals and entities seeking to operate within the nation's burgeoning network of technological and scientific parks. The instruction, dated November 15, 2024, and published in the Official Gazette (No. 200), provides clear guidelines on the required application format and procedures for obtaining user approval.

The instruction covers a wide range of aspects relevant to the application process:

- **Eligibility:** Any individual or legal entity, both Albanian and foreign, can submit a preliminary expression of interest to the park developer. The instruction provides a standardized format (referred to the instruction as Annex 1) for this expression.
- **Formal Application:** The request must include additional documentation to fulfill legal and technical requirements, following the format and forms attached to the said instruction. These forms include: Form 1 for the applicant's legal-administrative information, Form 2 for self-declaration, and Form 3 for the feasibility study. Once notified, the applicant must submit any additional documents required by the park developer within a 30-day period.
- **Application Procedures:** Applicants aiming to obtain approval for activities within the technological and scientific park must submit a request, accompanying forms, and any additional documentation specified by the Developer in the Open Call. These submissions can be made electronically or in written form, as outlined in the Open Call guidelines. The park's Developer holds the right to ask for further details regarding the submitted documents. Applicants can request clarifications via the developer's email and visit the park site, subject to technical availability. All applications must be submitted by the deadline set in the Open Call.
- **Higher Education Institutions:** The provisions in this instruction also apply to the inclusion of a higher education institution, whether domestic or foreign, that is accredited according to the relevant legislation of the country of origin.

This move is anticipated to make it easier for innovators, researchers, and businesses to leverage the resources and support offered by these dedicated parks. The simplified application process aims to attract a diverse range of users, fostering collaboration, innovation, and economic growth.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([Link](#))

Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 980, datë 15.11.2024 "Për përcaktimin e formës dhe mënyrës së paraqitjes së kërkesës për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parqeve teknologjike dhe shkencore"

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit e Shqipërisë ka publikuar Udhëzimin Nr. 980/2024, një direktivë gjithëpërfshirëse e krijuar për të thjeshtuar procesin për individët dhe subjektet që kërkojnë të operojnë brenda rrjetit në zgjerim të parqeve teknologjike dhe shkencore të vendit. Udhëzimi, i datës 15 nëntor 2024 dhe i publikuar në Fletoren Zyrtare (Nr. 200), ofron udhëzime të qarta mbi formatin e kërkesës dhe procedurat e nevojshme për të marrë miratimin si përdorues.

Udhëzimi mbulon një gamë të gjerë aspektesh të rëndësishme për procesin e aplikimit:

- **E drejta për të aplikuar:** Çdo individ ose subjekt juridik, shqiptar ose i huaj, mund të paraqesë një shprehje paraprake interesi tek zhvilluesi i parkut. Udhëzimi ofron një format të standardizuar (referuar në udhëzim si Aneksi 1) për këtë shprehje.
- **Aplikimi Formal:** Kërkesa duhet të përfshijë dokumentacion shtesë për të përmbushur kërkesat ligjore dhe teknike, duke ndjekur formatin dhe format e bashkangjitura në këtë udhëzim. Këto forma përfshijnë: Forma 1 për informacionin juridiko-administrativ të aplikantit, Forma 2 për vetë-deklarimin dhe Forma 3 për studimin e fizibilitetit. Pasi të njoftohet, aplikanti duhet të dorëzojë (nëse kërkohet) dokument shtesë të kërkuar nga zhvilluesi i parkut brenda një afati 30-ditor.
- **Procedurat e Aplikimit:** Aplikantët që synojnë të marrin miratimin për aktivitetet brenda parkut teknologjik dhe shkencor duhet të paraqesin një kërkesë, format shoqëruese dhe dokumentacion shtesë të specifikuar nga Zhvilluesi në Thirrjen e Hapur. Këto dorëzime mund të bëhen elektronikisht ose me formë të shkruar, siç përshkruhet në udhëzimet e Thirrjes së Hapur. Zhvilluesi i Parkut ka të drejtë të kërkojë detaje të mëtejshme lidhur me dokumentet e paraqitura. Aplikantët mund të kërkojnë sqarime përmes emailit të zhvilluesit dhe të vizitojnë faqen e parkut, në varësi të disponueshmërisë teknike. Të gjitha aplikimet duhet të paraqiten brenda afatit të përcaktuar në Thirrjen e Hapur.
- **Institucionet e Arsimit të Lartë:** Dispozitat në këtë udhëzim vlejnë gjithashtu për përfshirjen e një institucioni të arsimit të lartë, qoftë vendas apo i huaj, i cili është i akredituar sipas legjislacionit përkatës të vendit të origjinës.

Ky hap pritet të lehtësojë për inovatorët, kërkuuesit dhe bizneset shfrytëzimin e burimeve dhe mbështetjes së ofruar nga këto parqe të dedikuara. Procesi i thjeshtuar i aplikimit synon të tërheqë një gamë të larmishme përdoruesish, duke nxitur bashkëpunimin, inovacionin dhe rritjen ekonomike.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë ([Link](#))

Instruction No. 1093, dated 12.12.2024, "On the procedure for reviewing licensing applications and monitoring entities engaged in professional training activities."

The Albanian Ministry of Economy, Culture, and Innovation has issued Instruction No. 1093, dated December 12, 2024, establishing detailed procedures for licensing and monitoring entities engaged in professional training under category X.2.B (related to professional training).

- **Application Requirements:** Applicants are required to submit a detailed dossier, including original or notarized documentation verifying legal-administrative details, personnel qualifications, and evidence of ownership or lease of facilities, such as:
- **Declaration of Didactic Director:** The didactic director must be declared in the extract of the entity. In cases of non-governmental organizations lacking such an extract, the board's decision appointing the director must be presented. The didactic director is allowed to register with no more than two entities.
- **Personnel Qualification and Experience:** Personnel, including the didactic director and instructors, must meet specific educational and work experience requirements to ensure the quality of professional training offered.
- **Equipment, Technology and Facility Standards:** Applicants must demonstrate appropriateness in equipment, technology, and facilities aligned with service standards for the intended professional training courses.
- **Evaluation Process:** Applications submitted to the National Business Center undergo an initial electronic review to ensure completeness and compliance with subcategory X.2.B requirements. If deficiencies are found, the application is rejected with detailed feedback to guide resubmission. Fully complete applications are forwarded electronically to the National Employment and Skills Agency (AKPA) for further on-site inspection.
- **On-Site Inspection and Compliance Verification:** Once an application passes the preliminary stage, AKPA conducts an on-site inspection to verify adherence to specific licensing criteria. This process includes a detailed assessment documented in an official inspection report, which must be endorsed by both the legal representative of the entity and the inspection team. New documentation cannot be submitted during this inspection, ensuring that all required materials were initially present. Within seven days of the completion of the inspection, an evaluation report, along with the corresponding inspection record maintained at the entity and the photographs taken, is sent to the relevant directorate in the ministry responsible for AFP.

Udhëzim Nr. 1093, datë 12.12.2024 "Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licencim dhe monitorimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional"

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit e Shqipërisë ka nxjerrë Udhëzimin Nr. 1093, datë 12.12.2024, i cili përcakton procedurat e hollësishme për licencimin dhe monitorimin e entiteteve që merren me trajnimin profesional nën kategorinë X.2.B.

- **Kërkesat për Aplikim:** Aplikantët duhet të depozitojnë një dosje të detajuar që përfshin dokumentacionin origjinal ose të noterizuar që vërteton plotësimin e kushteve ligjore-administrative, kualifikimet e personelit dhe dokumentacionin mbështetës të pronësisë ose qirasë së objekteve.
- **Deklarata e Drejtuesit Didaktik:** Drejtuesi didaktik duhet të identifikohet në ekstraktin e shoqërisë. Në rastin e organizatave joqeveritare, në mungesë të ekstraktit, për drejtuesin didaktik duhet të paraqitet vendimi i bordit drejtues ku përcaktohet drejtuesi didaktik. Drejtuesi didaktik lejohet të regjistrohet në jo më shumë së dy subjekte.
- **Kualifikimi dhe Përvoja e Personelit:** Personeli, përfshirë drejtuesin didaktik dhe instruktorët, duhet të përmbushin kërkesat e caktuara për përshtatshmërinë e njohurive dhe të eksperiencës për të garantuar cilësinë e trajnimit profesional.
- **Standardet e Pajisjeve, teknologjisë dhe e mjediseve:** Aplikantët duhet të demonstrojnë se pajisjet, teknologjia dhe mjediset përmbushin standardet e shërbimit për kurset e trajnimit të synuara.
- **Procesi i Vlerësimit:** Aplikimet shqyrtohen fillimisht elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit lidhur dhe përputhshmërinë dhe përmbushjen me kërkesat e legjislacionit sipas nënkategorisë X.2.B. Në rast se gjatë shqyrtimit paraprak konstatohen mangësi në dokumentacion refuzon kërkesën, duke sqaruar shkaqet për mosmiratim, ndërsa aplikimet e plota kalojnë tek Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) për inspektim në vend.
- **Inspektimi në vend dhe Verifikimi:** AKPA kryen inspektime në vend për të verifikuar përmbushjen e kriterëve specifike të licencimit. Rezultatet dokumentohen në një aktin e ekspertimit që nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit dhe grupi i inspektimit. Dokumentacioni i ri nuk administrohet gjatë inspektimit. Brenda shtatë ditëve nga përfundimi i inspektimit, dërgohet një relacion vlerësimi, së bashku me aktin përkatës të inspektimit të mbajtur në subjekt dhe fotografitë e kryera, në drejtorinë përkatëse në ministrinë përgjegjëse për AFP-në.

Decision-Making and Appeals:

Approval: The relevant directorate in the ministry responsible for AFP reviews and approves applications, issuing decisions recorded in the National Register for Licenses and Permits, and coordinates with the National Business Center for license issuance under code X.2.B. A licensing fee of 10,000 lek is required, payable to AKPA and processed through e-Albania, with funds used per relevant legislation.

Rejection: Decisions to deny applications include specific reasons for rejection and are also documented in the National Register of licenses, authorizations, and permits, with notifications sent to the National Business Center.

Appeals: Applicants can contest rejections by filing an appeal within 10 working days. The responsible minister must decide on appeals within 10 working days. Unresolved disputes may be referred to the court within 30 days from the expiration of the appeal review period.

- **Revocation and Non-Compliance:** Licenses may be revoked for failure to comply with criteria, breaches of obligation, or any actions that jeopardize public interest.
- **Monitoring and Reporting:** Licensed entities must regularly document their training activities and maintain an updated register of participants, which is conducted via e-Albania.

For entities seeking licensing, adherence to these procedures and timely completion of documentation ensure a streamlined evaluation and inspection process. Compliance with the established requirements not only facilitates approval but also reinforces the entity's commitment to maintaining high standards in professional training services.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([Link](#))

Vendimmarja dhe Ankimet:

- **Miratimi:** Drejtoria përkatëse në ministrinë përgjegjëse shqyrton dhe miraton aplikimet, lëshon vendime që regjistrohen në Regjistrin Kombëtar për Licenca dhe Leje, dhe bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Biznesit për lëshimin e licencës sipas kodit X.2.B. Tarifa e licencimit prej 10,000 lekësh, paguar në AKPA, ngarkohet në e-Albania.
- **Refuzimi:** Vendime për refuzim përfshijnë shkaqet e refuzimit dhe regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, me njoftim ndaj QKB-së.
- **Apelimi:** Aplikantët mund të ankimojnë brenda 10 ditëve pune dhe ministri duhet të marrë vendim brenda 10 ditëve të punë. Mosmarrëveshjet e pazgjidhura mund ti referohen gjykatës brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të shqyrtimit të ankimit.
- **Revokimi dhe Mosrespektimi:** Licencat mund të revokohen për mosrespektim të kriterëve, shkelje të detyrimeve apo veprime që rrezikojnë interesin publik.
- **Monitorimi dhe Raportimi:** Entitetet e licencuara duhet të dokumentojnë rregullisht aktivitetet e tyre të trajnimit dhe të mbajnë një regjistër të përditësuar të pjesëmarrësve përmes e-Albania.

Për subjektet që kërkojnë licencim, respektimi i këtyre procedurave siguron një proces vlerësimi dhe inspektimi të drejtë dhe transparent. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara ndihmon jo vetëm në miratimin e licencës, por edhe forcon angazhimin për standarde të larta në trajnimin profesional.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë ([Link](#))



Decision No. 853, dated 26.12.2024 "On an amendment to decision no. 538, dated 26.5.2009, of the Council of Ministers, 'On licenses and permits processed by or through the National Business Center (NBC) and some other common sub-legal adjustments,' as amended."

The Council of Ministers has revised Decision No. 538, impacting professional training services under the National Business Center (QKB) jurisdiction.

Mandatory Update Requirement: License holders must align with new criteria and submit necessary amendments by August 30, 2025. **Failure to comply will result in license revocation.**

Entities should promptly review and update their licenses to ensure compliance and avoid any disruptions in operations.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([link](#))

Vendim Nr. 853, datë 26.12.2024 "Për një ndryshim në vendimin nr.538, datë 26.5.2009, të këshillit të ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (qkb) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar"

Këshilli i Ministrave ka amenduar Vendimin Nr. 538, duke impaktuar shërbimet e formimit profesional nën juridiksionin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Kërkesa për Përditësim të Detyrueshëm: Të gjithë mbajtësit e licencave duhet të përmbushin kriteret e reja dhe të paraqesin ndryshimet e nevojshme brenda datës 30 gusht 2025. **Mosrespektimi i këtij afati do të rezultojë në revokimin e licencës.**

Në këtë kontekst, ka shumë rëndësi që entitetet të rishikojnë dhe të përditësojnë licencat e tyre menjëherë për të siguruar përputhshmërinë dhe për të shmangur ndërprerjen e veprimtarisë së tyre.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë ([link](#))

Disclaimer

It is important to note that the content is for informational purposes only. It should not be considered legal advice or a replacement for personalized legal guidance. Readers are advised to consult professional legal counsel before taking any actions based on the information provided.

Should you require further clarification or wish to discuss any matters in depth, please feel free to reach out to our Legal Department (email: al_pwc_albania@pwc.com). We are committed to providing you with the assistance you need to navigate the complexities of new legislation requirements with confidence.

Përgjegjësim nga Përgjegjësia

Ky material ofrohet vetëm për qëllime informimi dhe nuk duhet konsideruar si këshillim ligjor apo zëvendësim i konsulencës ligjore të personalizuar. Lexuesit këshillohen të konsultohen me profesionistë të kualifikuar ligjorë përpara se të ndërmarrin veprime bazuar në informacionin e dhënë.

Nëse ju kërkoni sqarime të mëtejshme ose dëshironi të diskutoni më hollësisht mbi çështje specifike, ju lutemi të kontaktoni Departamentin tonë Ligjor (email: al_pwc_albania@pwc.com). Ne jemi të përkushtuar t'ju ofrojmë mbështetjen e nevojshme për t'ju orientuar ndaj kërkesat e reja legjislative.





Let's talk

PricewaterhouseCoopers Albania

Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1 Tirana, Albania

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

